



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2021, mori këtë

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01-353/01-82495/21, TË DT. 12.05.2021, PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E OBELISKUT NË SHENJË MIRËNJOHJE PËR PROFESIONISTËT SHËNDETËSORË DHE NË NDERIM TË ATYRE QË KANË NDËRRUAR JETË NGA VIRUSI COVID-19

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01-353/01-82495/21, të dt.12.05.2021, për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19.

II.

Sipas vendimit të cekur në pikën I, plotësim-ndryshimi nënkupton:

1. Ndryshohet pika II e Vendimit, në vend të pjesës së parcelës kadastrale, nr. 2723-0, ZK Prishtinë, në pronësi – pronë shoqërore, KK Prishtinë, ndryshohet me parcelën kadastrale, nr. 2722-0, ZK Prishtinë, në pronësi shoqërore, KK Prishtinë.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-185470/21, më 03.09.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

